



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

(Dekument Parlamentar)

Tiranë, më 18. 11. 2019

RAPORT
PËR PROJEKTLIGJIN
“ PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

-Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në disa seanca të mbledhjeve të tij të datave 14,15, nëntor 2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020”. Kjo nismë është propozim i Këshillit të Ministrave. Relatore e projektligjit është znj. Lindita Nikolla.

Në diskutimin në parim të projektligjit ishin të pranishme dhe dhanë shpjegime rreth tij znj. Besa Shahini, Ministre e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; znj. Elva Margariti, Ministre e Kulturës; znj. Dajna Sorensen, zv/Ministre e Financave dhe Ekonomisë, si dhe ekspertë të ministrive përkatëse. Gjithashtu, u organizuan seanca dëgjimore me institucione që financohen edhe nga Buxheti i Shtetit.

I.BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81-83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës, sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

II.QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Sipas relacionit shoqërues, që në fillim theksohet se Projektbuxheti 2020 vijon të mbështesë reformat e ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritetit në Bashkimin Europian.

Ky projektbuxhet dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal për të vijuar **trajektoren rënëse të raportit të borxhit publik ndaj PBB**. Rritja ekonomike parashikohet të jetë mbi nivelin prej 4% përgjatë viteve 2020-2022. Rritja ekonomike dhe punësimi, do të mbështeten edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të **investimeve publike prej 4.7% e PBB**.

Defiçiti buxhetor për vitin 2020 planifikohet të jetë në nivelin 1.6% të PBB. Ky përbën nivelin më të ulët të targetuar në dy dekadat e fundit. Në fund të vitit 2020 borxhi publik pritët të ulët në nivelin e 62.2% të PBB

2.2. Risitë e projektligjit

Risitë e projektligjit reflektohen në një sërë treguesish të projektbuxhetit të Vitit 2020.

Qëndrueshmëria e financave publike dhe vijimi i konsolidimit fiskal. Qëndrueshmëria e financave publike përbën një tjetër fundament tejet të rëndësishëm për perspektivën e ekonomisë.

Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.1% në vitin 2020, ndërkohë që norma mesatare e papunësisë parashikohet të bjerë në 10.6% në vitin 2020.

Projektbuxheti 2020, planifikon më shumë burime si rezultat i politikave fiskale, të cilat do të vazhdojnë të fokusohen në realizimin e një taksimi të ndershëm, si dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Përmirësime të ndjeshme do ketë në mënyrën efikase të administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi, gjë që sjell rritjen e të ardhurave.

Përmes këtij buxheti, shikohet qartë synimi që barra fiskale të shpërndahet në mënyrë të drejtë, duke patur në qendër të vëmendjes uljen e ngarkesës për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Interes paraqesin shpenzimet buxhetore 2020-2022, të cilat shoqërohen me rritjen e nivelit të investimeve publike, ku prioritare është financimi i projekteve të rëndësishme strategjike, duke synuar që shpenzimet e planifikuara të finalizojnë projektet e rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë.

Rijetëzimi rural do të vijojë të mbetet në qendër të vëmendjes së qeverisë, ku vend mjaft të rëndësishëm vijon të ketë programi “100 fshatrat”.

Ky projektbuxhet garanton vijimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të sektorëve kyç të ekonomisë, si reforma në drejtësi, në administratën publike, si dhe në menaxhimin e financave publike.

Shprehje kuptimplotë e vullnetit dhe seriozitetit të Qeverisë është, në mes të tjerash, mbështetja e **Reformës administrativo-territoriale dhe reformave të tjera të decentralizimit**, ku burimet e financimit të vetëqeverisjes vendore do të **rriten me rreth 5.7 miliardë lekë ose 11.2% më shumë** sesa ato të vitit 2019, të cilat do shkojnë për më shumë investime dhe përmirësimin e shërbimeve publike etj..

Përmes reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit, Qeveria në këtë buxhet i jep vend të rëndësishëm vazhdimit dhe konsolidimit të **reformës së financimit të arsimit parashkollor**. Edhe për vitin 2020, **fondet për pagat e edukatorëve do të rriten me 10%** në krahasim me vitin 2018, si viti para fillimit të kësaj reforme. Në të njëjtën kohë, do të **përmirësohet sistemi i ndarjes së fondeve ndërmjet bashkive**.

Ky buxhet krahasimisht me vitet e kaluara ka përmirësime të ndjeshme dhe në arsimin parashkollor, të mesëm të përgjithshëm, të mesëm profesional dhe arsimin e lartë, në fushën e kulturës, rinisë dhe sporteve.

Buxheti i MASR 2020

Në sektorin e arsimit për periudhën afatmesme 2020-2022, fondet ku janë pjesë e buxhetit të arsimit, të ardhurat dytësore të IAL-ve publike, si dhe të ardhurat e tjera nga të tretë, përfshirë buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes, pjesa për arsimin e buxhetit të njërive të pushtetit vendor, si dhe fondet nga projekte të veçantë të donatorëve (*pa përfshirë shpenzimet familjare dhe shpenzimet për arsimin nga institucione private), *në vitin 2022 parashikohet të arrijnë në 63.9 miliardë lekë*, krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin *parashikohet të arrijnë në 10.9% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto në 3.14%*.

Fondet buxhetore të parashikuara në projektligjin vjetor “Për buxhetin e vitit 2020” për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në vitin 2020 janë 42 miliardë e 534 milion lekë, *me një rritje mesatare vjetore që shkon 3.1% ose 1 miliard e 287 milionë lekë ndaj vitit paraardhës*.

Për vitin 2021, fondet e planifikuara janë në masën **42 miliardë e 912 milionë lekë**, me një rritje mesatare vjetore që shkon në 0.6% ose 377.3 milionë lekë ndaj vitit paraardhës.

Për vitin 2022, fondet e planifikuara janë në masën **45 miliardë e 306 milionë lekë**, me një rritje mesatare vjetore që shkon në 5.6% ose 2 miliardë 393.9 milionë lekë ndaj vitit paraardhës, ku rritja më e madhe prej 1.9 miliardë lekë është planifikuar në fondet grand për financimin e IAL-ve publike.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, në përmbushje të Programit të Qeverisë, prioritet të punës saj në vitet 2020-2022 do ketë mbështetjen e arsimit bazë, të mesëm dhe të lartë, orientimin e kurrikulave ndaj nevojave të tregut të punës dhe modernizimin e tyre, si dhe mbështetjen për trajnim dhe punësim të kategorive të veçanta. Për periudhën 2020-2022, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë do të financojë me prioritet: transportin e 28-30 mijë nxënësve që kanë vendbanim mbi 2 km nga shkolla, si dhe transportin e 9-12 mijë mësuesve që punojnë mbi 5

km nga vendbanimi/qendra e përhershme e punës në shkollë; blerjen e teksteve shkollore për rreth 230-250 mijë nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë; për 1300-1400 nxënës të arsimit parauniversitar nga shtresat sociale në nevojë do të garantohet trajtimi me kuotë ushqimore; mbështetje e vazhdueshme për studentët, përmes mbulimit të shpenzimeve për bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë; krijimit të kushteve të përshtatshme të akomodimit në tetë “Shoqëritë e Trajtimit të studentëve në Tiranë dhe në Rrethe” për rreth 8-10 mijë studentë; mbështetje me bursa të rreth 100-120 studentëve të rinj ekselentë që ndjekin studimet në 15 universitetet më të mira, referuar renditjes së “Times Higher Education”; fonde për të mbuluar shpenzimet për rishikimin e kurrikulës dhe hartimin e programeve të arsimit parauniversitar për veprimtarinë e Institutit të Zhvillimit të Arsimit me 20 -25 milionë lekë në vit; fonde për të mbuluar shpenzimet për veprimtarinë e Maturës Shtetërore, provimet e shtetit, si dhe testime kombëtare e ndërkombëtare me 25 milion lekë në vit etj.

Për arsimin parauniversitar për periudhën 2020-2022 synohet si më poshtë :

- Të sigurohet rritja e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor 86%, ndjekja e arsimit bazë (nga 100% e moshës 6-16), si dhe përfshirja me përparësi e grupeve vulnerabël. Rritja e treguesit të regjistrimit me 10-15% ose 350-500 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me aftësi të kufizuara. Reformimi i arsimit parashkollor dhe bazë, përmes miratimit të kornizës së re kurikulare dhe programeve për çdo grup moshe për arsimin parashkollor bazë. Njëkohësisht do vijojë trajnimi i përvitshëm i edukatorëve, mësuesve dhe punonjësve të shërbimit psikosocial 150 psikologë dhe 150 punonjës social); zbatimi/implementimi i kurrikulës së re klasa 1-5 dhe klasa 6-9; përgatitja e programeve, moduleve të trajnimit; trajnimi i 12.000 mësuesve për kurikulën e re, përfshirë dhe 40 mësues të pakicave kombëtare;sigurimi i transportit të nxënësve për ndjekjen e arsimit parashkollor dhe bazë që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre si dhe mësuesve që punojnë e banojnë më shumë se rreth 5 km nga vendbanimi i tyre dhe mbulimi 100% i shpenzimeve të transporti me fonde të buxhetit; numri i nxënësve që regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm të lartë të arrijë në 95-97% e nxënësve që përfundojnë arsimin bazë, nga të cilët 65% ndjekin AM gjimnaze dhe 35% në arsimin profesional; përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese në sistemin parauniversitar etj..

Fondet buxhetore për vitin 2020 për arsimin profesional janë 3.28 miliarë lekë, me një rritje prej 9.4 milionë lekë në krahasim me vitin 2019 (1%). Për vitin 2020 buxheti i planifikuar ka rritje në zërat e shpenzimeve: në shpenzime korrente buxheti është planifikuar me 169.5 milionë lekë më shumë, fond i cili është i mjaftueshëm për të zhvilluar politikat ekzistuese dhe politikat e reja në fushën e arsimit profesional; është planifikuar me rritje buxheti për bursat e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin profesional; do stimulohen me bursë dhe nxënëset (vajzat) që ndjekin drejtimet mësimore tipike për meshkuj (elektroteknikë, gjeodezi, termohidraulikë etj.). Investimi në AFP është ndër investimet më të domosdoshme, që kanë impakt të sigurtë dhe të drejtpërdrejtë në zhvillimin e biznesit dhe rritjen ekonomike të vendit, pasi i përgjigjet mungesave për punonjës të kualifikuar etj.. Prioritet gjatë periudhës 2020-2022 që synohen në fushën e arsimit profesional dhe punësimit janë: rritja e numrit të të punësuarve pas diplomimit në shkollat e mesme

profesionale, rritja e numrit të nxënësve me aftësi të kufizuar që ndjekin studimet në shkollat e mesme profesionale etj..

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor për periudhën 2020-2022 parashikohet sa më poshtë:

100% të programeve studimore të akredituara brenda vitit 2030; të sigurohet standardi një vend pune për dy studentë në laboratorë kërkimorë - shkencorë, në përputhje me parimet e barazisë gjinore; sigurimi i standardit 5-8 m² për student, sipas natyrës së programit të studimeve në vitin 2022, në përputhje me parimet e barazisë gjinore; fondet publike për IAL-të të arrijnë në 2% ndaj PBB-së në vitin 2022; 100% e të dhënave të stafit akademik, të studentëve, të karrierës akademike, diplomimit janë në regjistrin elektronik kombëtar; 90% e stafit me kohë të plotë në departamente të jenë me grada/tituj në 2022-shin, në përputhje me parimet e barazisë gjinore; 100% e studentëve ekselentë, studentë në nevojë të përfitojnë bursa e kredi studentore në 2022-shin; numri i kërkuesve deri në vitin 2021 të arrijë treguesit mesatarë për kërkues në OECD; rritja me 30% e financimit të projekteve kombëtare të kërkim - zhvillimit që drejtohen nga kërkuese femra dhe doktoratave të fushave prioritare të kërkimit, me synim që pas vitit 2021, të sigurohet barazi gjinore në projektet fituese; të rritet me 10%-15% në vit numri i aplikimeve nga programet bilaterale dhe Programin “Horizon 2020”, si dhe programet “ERASMUS +”; *fonde grant “fondi i mbështetjes studentore”, për periudhën 2020-2022 janë parashikuar fonde për të mbuluar shpenzimet për bursat e studentëve nga shtresat sociale në nevojë, si dhe studentëve ekselentë në IAL-të publike në këtë grup shpenzimesh në shumën e parashikuar prej 1.1 miliard lekë deri në 1.2 miliardë lekë në vit etj..*

Për sportin dhe rininë për periudhën 2020-2022 parashikohet: sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpike në aktivitete europiane, botërore, ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpike Japoni 2020; mbështetja financiare për Ekipin Kombëtar Olimpik pjesëmarrës në Lojërat Olimpike Japoni 2020, si dhe aktivitetet kombëtare dhe ndërkombëtare për Federatat Sportive, në të gjithat disiplinat sportive, sipas kalendarëve të aktiviteteve; mbështetja financiare me investime në sport, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisje me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare; rritja e mbështetjes financiare për shpërblimin e sportistëve elitari; përmirësimi i cilësisë së jetës së të rinjve, përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre në punësim, në informim, në edukim dhe në vendimmarrje; mbështetja financiare me investime për ristrukturimin/ ndërtimin dhe pajisjen e objekteve për rininë, në funksion të përmirësimit të kushteve për argëtim etj..

Buxheti për Ministrinë e Kulturës

Ministria e Kulturës procesin e hartimit të PBA-së 2020-2022 e ka vlerësuar si një moment të rëndësishëm në mbështetje të objektivave të Programit të Qeverisë, për zhvillimin e **Art - Kulturës, Trashëgimisë Kulturore & Muzetë**. Projektbuxheti i vitit 2020 krahasuar me projekt buxhetin e vitit 2019 ka një rritje prej 11,7 % ose 253,3 milionë lekë.

Në fushën e Trashëgimisë Kulturore rritja prej 38,6 milionë lekë në shpenzimet korrente do të përdoren kryesisht për mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e objekteve specifike, si restaurimet e afreskeve, pikturave dhe mirëmbajtje e monumenteve etj.. Duhet theksuar se në vitin 2020 është parashikuar të organizohet Festivali i Gjirokastrës, për të cilin nga MK është kërkuar në PBA 2020-2022 një fond shtesë prej 80 milionë lekë.

Në fushën e Artit dhe të Kulturës me shpenzimet korrente do të realizohen kryesisht një rrjet aktivitetesh që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e artit shqiptar në arenën ndërkombëtare (Bienale Venecias, Creative Europe, Traduki, Marrëveshja me Kosovën etj.).

Mbështetja e aktiviteteve kulturore në mbarë vendin nëpërmjet thirrjeve për aplikime në fushën e artit dhe kulturës, të librit dhe përkthimit etj..

Institucionet e vartësisë së këtij programi do të realizojnë një sërë veprimtarish artistike-kulturore, do të realizojnë premiera, si dhe rivënie. Në realizimin e veprimtarive të ndryshme artistike do të jetë prioritet integrimi, angazhimi dhe promovimi i të rinjve më të evidentuar të kësaj fushe. Por fondet që disponon MK për organizimin e këtyre aktiviteteve janë të pamjaftueshme për realizimin tyre me cilësi, prandaj kemi kërkuar një fond prej 75 milionë lekë.

Prioritete në vitet 2020 -2022 në fushat e kulturës dhe trashëgimisë kulturore do të jenë Programi Kombëtar “Edukimi përmes Artit”, përmirësimi i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës, përmirësimi i infrastrukturës në Muzetë Kombëtarë, Parqe Arkeologjike, edukimi përmes librit dhe veprimtarive bibliotekare, pasurimi i fondit bibliotekar në të gjithë rrjetin e bibliotekave në mbarë vendin, me qëllim rritjen dhe edukimin e lexuesit, rritja e aksesit të publikut në Muze, monumentet e kulturës, ansambleve arkitektonike, qyteteve muze, qendrave historike, zonave dhe parqeve arkeologjike në funksion të turizmit kulturor; rritja e numrit të projekteve me thirrje në mbështetje e industrive krijuese, duke respektuar barazinë gjinore, të drejtat e njeriut, grupet e marginalizuara dhe diversitetin kulturor në rang vendi nga 80 në vitin 2019 në 100 në vitin 2022 etj..

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Komisioni, mbështetur në nenin 36, pika 1 dhe nenin 80, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, ka realizuar seanca dëgjimore me aktorë të interesit, si: Akademinë e Shkencave; Akademinë e Studimeve Albanologjike, RTSH-në; QKK-në, universitetet publike, si në Tiranë dhe në rrethe dhe ATSH-në.

Akademia e Shkencave ka vlerësuar mbështetjen nga qeveria për buxhetin e saj edhe për vitin 2020. Drejtuesit e Akademisë theksuan se ligji nr.53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” përcakton dhe një sërë detyrash të reja ndaj Akademisë, ku në esencë i kërkohej që të luajë një rol primar në promovimin, koordinimin, organizimin e drejtimin e kërkimit shkencor në Shqipëri e veçanërisht në drejtim të kërkimit në fushat e Albanologjisë për

mbrojtjen, pasurimin e përmirësimit të gjuhës standarde. Në organikën e re do të parashikohet përveç shtimit të kancelarit, edhe ngritja e një njësie të projekteve e monitorimi etj.. *Për realizimin me efektivitet të veprimtarisë saj, Akademia e Shkencave kërkon shtesë fondi prej 20 milionë lekësh.*

Akademia e Studimeve Albanologjike ka vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020”, por njëkohësisht parashtroi një sërë çështjesh që lidhen me funksionimin e saj. Duke dhënë të detajuar kërkesa për vitin 2020, investime kapitale, si rikonstruksioni i Muzeut Arkeologjik, Tiranë, rikonstruksioni i Shtëpisë së Arkeologëve në Apolloni etj., kërkoi një fond prej 70 milionë lekësh, si dhe kërkesa shtesë për shpenzime operative.

RTSH

Drejtnesit e RTSH-së gjatë seanceës dëgjimore u ndalën në punën e mirë që është bërë në këtë institucion publik gjatë viteve të fundit, por në mënyrë të veçantë parashtroan një varg vështirësish që lidhen me projektet teknike për futjen e teknologjive të reja, digjitalizimin e arkivit, funksionimin e Orkestrës Simfonike, Shërbimit për Shqiptarët jashtë kufirit të Shërbimit në Gjuhë të huaj etj., ku në total janë parashikuar 634 milionë lekë.

Ata kërkuan të shtohet Buxheti për RTSH-në me 585 milionë lekë.

Komisioni sugjeron që të mbështetet RTSH me 425 milionë lekë për kryerjen e veprimtarisë së tij.

ATSH

ATSH-ja, duke vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020”, thekson se është përpjekur që kërkesat e këtij institucioni të jenë sa më realiste. Evidenton një sërë treguesish të veprimtarisë së saj, siç është rritja gjatë vitit 2019 e komunikimit me agjenci me reputacion jashtë vendit, si Agjencia Gjermane e Lajmeve (DPA), Agjencia Kineze e Lajmeve XINUAH, Agjencia Sllovene e Lajmeve STA etj., në faqet e të cilave shfaqen lajme nga Shqipëria.

Po kështu, ATSH-ja këtë vit dhe vitin që vjen ka parashikuar konferenca dhe evente ndërkombëtare.

Duke vlerësuar mbështetjen e vitit të kaluar nga Komisioni për kërkesat buxhetore, për vijimësinë e procesit të digjitalizimit të Arkivit të Fotografisë dhe buletinet e shkruara etj., kërkohet shtesë në buxhetin e vitit 2020 në vlerën 5 milion lekë.

ATSH vë në dukje se investimet e planifikuara prej 1 milion lekë, bëjnë të pamundur të përmirësojnë përmirësimin teknologjik etj..

Komisioni sugjeron që ATSH-ja të mbështetet me shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020 në vlerën e 4 milionë lekëve.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë(QKK)

Drejtesit e këtij institucioni u shprehën se QKK-ja, si i vetmi institucion i specializuar në vend, që harton dhe zbaton politikat kinematografike dhe mbështet ekonomikisht prodhimin e filmit në Republikën e Shqipërisë, ndodhet në një monment kyç të zhvillimit të saj.

Tavanet e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022 thekson QKK-ja nuk përmbushin nevojat e funksionimit saj. Ndja, kërkon shtesë fondi 40 milionë lekë për rimbursimin e pjesshëm të investimeve të produksioneve të huaja, që zhvillojnë xhirime filmi në territorin e Shqipërisë; 13 milionë shtesë fondi për projektin “Festivali i 14 Kombëtar i Filmit Shqiptar” etj..

Komisioni sugjeron që QKK-së t’i shtohen 13 milionë lekë.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, vlerëson buxhetin e dhënë për ndërtimin e godinës për ruajtjen e fondeve arkivore, tashmë e përfunduar. Por për të përmbushur misionin për të cilin po kryhet ky investim, mbetet domosdoshmëri pajisja me raftet për vendosjen e fondeve arkivore, që sipas preventivit paraprak shkon afërsisht në shumën prej 80 milionë lekë të kërkuara nga DPA-ja.

Miratimi i pjesës tjetër të investimit prej 80 milionë lekësh për raftet, është mjaft i rëndësishëm, për të përfunduar me sukses ndërtimin e vendruajtjes së dokumenteve në Shkozë. Ky është investimi më i madh për arkivat në 30 vjet dhe krijon mundësi për ruajtjen e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare dhe për 7 dekada të tjera.

Komisioni sugjeron që të mbështetet kërkesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për të realizuar veprimtarinë e saj.

Universitetet Publike

Në seancat dëgjimore të organizuara me rektorë dhe administratorë të universiteteve publike të Universitetit të Tiranës, Universitetit të Sporteve të Tiranës, Universitetit të Mjekësisë të Tiranës, Universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, Universitetit “Ismael Qemali” të Vlorës, Universitetit “Fan S. Noli” të Korçës, si dhe në materialet e dërguara me shkrim nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti “Aleksandër Moisiu” të Durrës, vlerësohet buxheti i këtij viti, i cili krahasimisht me vitin e kaluar parashikon rritje të fondeve të buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë, grantin e politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë (rritja 14 %); grantin e mësimdhënies (rritja 32%); grantin e punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese (rritja 5%).

Universiteti i Tiranës, vlerëson projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020”, por kërkon rritjen e tij për përmirësimin e kushteve të studentëve; veçanërisht u përqëndrua në çështjen e doktoraturave, për të cilat kërkohen fonde etj..

Universiteti Mjekësor i Tiranës

Universiteti Mjekësor i Tiranës vlerësoi mbështetjen buxhetore të dhënë nga Qeveria Shqiptare për vitin 2019. UMT kërkon të mbështetet nga pikëpamja financiare përmes: mbulimit

për 12 muaj të pagave dhe sigurimeve shoqërore; mbështetje financiare për të realizuar një shtesë të ambienteve të mësimdhënies për Fakultetin e Mjekësisë Dentare (FMD); mbështetje financiare për të realizuar një shtesë të ambienteve të mësimdhënies për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT).

Universiteti i Sporteve i Tiranës, duke vlerësuar buxhetin e këtij viti, u ndal në specifikat që ka ky universitet dhe në lidhje me buxhetin kërkoi investime kryesisht në ambiente, për të cilat janë gati projektet dhe pajisje për laboratorët; për rikonstruksionin e fushës së futbollit dhe pistës së atletikës nga buxheti 45.000.000 lekë; për ndërtimin e shtesës së palestrës së gjimnastikës, kërkesë dhe e studentëve, kërkon fonde 31 912 000 lekë; ndërtimi i pishinës, ndërtimi i një ndërtese katërkatëshe etj., kërkon fonde të shumta, që mundësojnë zhvillimin normal të procesit mësimor në Universitetin e Sporteve.

Universiteti Politeknik i Tiranës vlerëson rritjen e fondeve të buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë në grantin e politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë (rritja 14 %); grantin i mësimdhënies (rritja 32%); grantin e punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese (rritja 5%); kërkon që procesi i shpalljes së thirrjeve, vlerësimit të projekteve dhe alokimit të fondeve nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, të nisë që në fillim të vitit financiar, pasi në të kundërt rrezikohet që këto fonde për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion që mbetet për IAI-të, të mos shpenzohen. Duke u ndalur në lekundjet sizmike që ndodhën së fundi, thekson se është emergjente nevoja për ndërhyrje dhe rehabilitimin strukturor të godinave, ku ndër prioritetet kryesore për të cilin kërkohet financim në vitin 2020, renditet projekti për rehabilitimin infrastrukturor të godinës së Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, pa përmenduar godinën historike të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, për të cilën fondet janë siguruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet donacioneve të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në industrinë e gazit, naftës dhe atë minerare etj..

Universiteti “Aleksandër Xhuvani” parashtroi kërkesat për mbarëvajtjen e procesit akademik e kërkimor dhe realizimin e planit kombëtar për integrimin europian 2016–2020, duke theksuar se është e nevojshme: rimbursim nga Buxheti i Shtetit 100% të të ardhurave që nuk arkëtohen, si pasojë e zbatimit të akteve nënligjore për uljen apo reduktimin e pagesës së tarifave të shkollimit; financimi nga Buxheti i Shtetit i fondeve të kërkimit shkencor; financimi nga Buxheti i Shtetit i objektit “Ndërtim i godinës së Fakultetit të Shkencave Humane” në vlerën 489,455 mijë lekë, ndërkohë që të ardhurat e Universitetit ka dy vite që janë ngurtësuar në Degën e Thesarit fondi nga të ardhurat, prej 140,000 mijë lekë; financimin nga Buxheti i Shtetit të projekteve për pajisjet laboratorike.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, kërkoi shtesë në buxhet për ngritjen e godinës së re për Fakultetin e Shëndetit Publik; përmirësimin e sistemit të ngrohjes së godinave; shtimin e laboreve, (inxhinieria elektrike, mekanike, navigacion, pedagogji e specializuar, infermieri); rritjen e fondit për kërkimin shkencor dhe përfshirjen e studentëve të kërkimi shkencor.

Universiteti “Fan S. Noli” Korçë, në kuadër të hartimit të Projektit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2020-2022, referuar Paktit për Universitetin, shprehu nevojat për mbështetje financiare për,

referuar VKM, nr. 39, datë 23.01.2019 dhe VKM nr. 40, datë 23.01.2019; kërkojnë me **domosdoshmëri** financimin e projektit të **rikonstruksionit të godinës së Fakultetit Ekonomik**, vlera e paraprake e projektit në fjalë është **62,500,000 lekë**; kërkohet rritje e financimit buxhetor për përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturës së laboratorëve e pajisjeve profesionale në shumën **30,420,000 lekë** për plotësimin e kërkesave për krijimin e laboratorëve të rinj në fusha të ndryshme studimi; rritje prej **4,000,000 lekësh** për kërkimin shkencor të universitetit.

Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës kërkon që qeveria të vazhdojë të mbështesë Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, duke garantuar fonde për mbështetjen studentore për të përballuar të gjithë efektin financiar që sjell zbatimi i VKM-së nr. 39, datë 23.01.2019 dhe VKM-së nr. 40, datë 23.01.2019 etj.. Ky universitet në vitin 2018 ka përfunduar ndërtimin e godinës së dytë të Kampusit Universitar. Aktualisht ky institucion ka ende të pashlyer një vlerë të konsiderueshme detyrimi të kontratave që lidhen me ndërtimin e kësaj godine, konkretisht kontrata e ndërtimit, kontrata e arredimit të brendshëm etj.. Në vitin 2020 të ardhurat e institucionit pritet të shkojnë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Nisur nga ky fakt, kërkohet rritje e buxhetit për vitin 2020 për Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, për të përballuar të gjitha shpenzimet për funksionimin e institucionit (shpenzime për personelin dhe shpenzime operative të domosdoshme). Po kështu, kërkohet shtesë buxheti për financimin e projekteve kërkimore - shkencore.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2019” në tërë komponentët e tij, me votat e të gjithë deputetëve të pranishëm (përjashto votën kundër të Kryetares së Komisionit), miratoi në parim projektligjin dhe i paraqet Raportin e tij Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORE

Lindita NIKOLLA

KRYETARE

Fatjona DHIMITRI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

(Dekument Parlamentar)

Tiranë, më 11. 12. 2019

RAPORT

PËR DISKUTIMIN NEN PËR NEN DHE NË TËRËSI TË PROJEKTLIGJIT
“ PËR BUXHETIN E VITIT 2020”

Hyrje

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e tij të datës 11.12. 2019, mori në shqyrtim nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020”, propozim i Këshillit të Ministrave. Gjatë shqyrtimit nen për nen Komisioni u njoh dhe me sugjerimet e dërguara me shkrim nga shoqëria civile, aktorët e interesit dhe sindikatat e arsimit.

Relatore e projektligjit është znj. Lindita Nikolla.

Në mbledhjet e Komisionit, gjatë diskutimit nen për nen ishin të pranishëm nga MASR: znj. Mirela Bimo, drejtoresh e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; z. Florian Nurçe, përgjegjës Sektori, Sektori i Buxhetit, Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; nga Ministria e Kulturës: z. Shpëtim Shehu, drejtor i Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar; nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë: znj. Vilma Causholli dhe znj. Suzana Stefa.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është nismë e Këshillit të Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 81-83, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 80 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI, PËRMBAJTJA DHE RISITË E PROJEKTLIGJIT

2.1. Qëllimi i projektligjit:

Në tërë aspektet e përmbajtjes së projektligjit “Për Buxhetin e Vitit 2020”, Komisioni është shprehur gjërësisht gjatë diskutimit në parim të tij.

Sipas relacionit shoqërues, që në fillim theksohet se Projektbuxheti 2020 vijon të mbështesë reformat e ndërmarra që promovojnë rritjen ekonomike, punësimin, përmirësimin e cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarit dhe procesin e integritetit në Bashkimin Europian.

Ky projektbuxhet dhe ai afatmesëm bazohen në një kuadër makroekonomik të kujdesshëm dhe realist. Politika fiskale do të vijojë të orientohet drejt konsolidimit fiskal për të vijuar trajektoren rënës të raportit të borxhit publik ndaj PBB. Rritja ekonomike parashikohet të jetë mbi nivelin prej 4% përgjatë viteve 2020-2022. Rritja ekonomike dhe punësimi do të mbështetet edhe nga objektivi tjetër i planifikuar në këtë buxhet, ai i sigurimit të një niveli të lartë të investimeve publike prej 4.7% e PBB etj.

2.2. Risitë e projektligjit

Risitë e projektligjit reflektohen në një sërë treguesish të Projektbuxhetit të Vitit 2020.

Qëndrueshmëria e financave publike përbën një tjetër fundament tejet të rëndësishëm për perspektivën e ekonomisë. Rritja ekonomike parashikohet të vijojë të forcohet dhe të arrijë nivelin 4.1% në vitin 2020, ndërkohë që norma mesatare e papunësisë parashikohet të bjerë në 10.6% në 2020.

Projektbuxheti 2020 planifikon më shumë burime, si rezultat i politikave fiskale, të cilat do të vazhdojnë të fokusohen në realizimin e një taksimi të ndershëm, si dhe në nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Përmes këtij buxheti shikohet qartë synimi që barra fiskale të shpërndahet në mënyrë të drejtë, duke patur në qendër të vëmendjes uljen e ngarkesës për grupe, kategori dhe sektorë të caktuar.

Interes paraqesin shpenzimet buxhetore 2020-2022, të cilat shoqërohen me rritjen e nivelit të investimeve publike, ku prioritare është financimi i projekteve të rëndësishme strategjike, duke synuar që shpenzimet e planifikuara të finalizojnë projektet e rrugëve nacionale, mbështetjen e sektorit të ujit, shëndetësisë, arsimit dhe sektorit të bujqësisë.

Rijetëzimi rural do të vijojë të mbetet në qendër të vëmendjes së qeverisë, ku vend mjaft të rëndësishëm vijon të ketë programi *100 Fshatrat*.

Ky projektbuxhet garanton vijimin e mbështetjes financiare për thellimin e reformave të sektorëve kyç të ekonomisë, si reforma në drejtësi, në administratën publike, si dhe në menaxhimin e financave publike.

Përmes reformës administrativo-territoriale dhe decentralizimit, Qeveria në këtë buxhet i jep vend të rëndësishëm vazhdimin dhe konsolidimin të reformës së financimit të arsimit parashkollor. Edhe për vitin 2020, fondet për pagat e edukatorëve do të rriten me 10% në krahasim

me vitin 2018, si viti para fillimit të kësaj reforme. Në të njëjtën kohë do të përmirësohet sistemi i ndarjes së fondeve ndërmjet bashkive.

Ky buxhet, krahasimisht me vitet e kaluara, ka përmirësime të ndjeshme dhe në arsimin parashkollor, të mesëm të përgjithshëm, të mesëm profesional dhe arsimin e lartë, në fushën e kulturës, rinisë dhe sporteve.

Buxheti i MASR 2020.

Në sektorin e arsimit për periudhën afatmesme 2020-2022, fondet ku janë pjesë e buxhetit të arsimit, të ardhurat dytësore të IAL publike, si dhe të ardhurat e tjera nga të tretë, përfshirë buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, pjesa për arsimin e buxhetit të njësive të pushtetit vendor, si dhe fondet nga projekte të veçantë të donatorëve (*pa përfshirë shpenzimet familjare dhe shpenzimet për arsimin nga institucione private), në vitin 2022 parashikohet të arrijnë në 63.9 miliard lekë; krahasuar me shpenzimet publike fondet për arsimin parashikohet të arrijnë në 10.9% dhe ndaj produktit të brendshëm bruto në 3.14%.

Fondet buxhetore të parashikuara në projektligjin vjetor “Për buxhetin e vitit 2020” për Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në vitin 2020 janë 42 miliardë e 534 milionë lekë, me një rritje mesatare vjetore që shkon 3.1% ose 1 miliard e 287 milionë lekë ndaj vitit paraardhës.

Për vitin 2021, fondet e planifikuara janë në masën 42 miliardë e 912 milionë lekë, me një rritje mesatare vjetore që shkon në 0.6% ose 377.3 milion lekë ndaj vitit paraardhës.

Për vitin 2022, fondet e planifikuara janë në masën 45 miliardë e 306 milionë lekë, me një rritje mesatare vjetore që shkon në 5.6% ose 2 miliardë 393.9 milionë lekë ndaj vitit paraardhës, ku rritja më e madhe prej 1.9 miliardë lekë është planifikuar në fondet grand për financimin e IAL publike.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë në përmbushje të Programit të Qeverisë prioritet të punës saj në vitet 2020-2022 do ketë mbështetjen e arsimit bazë, të mesëm dhe të lartë, orientimin e kurrikulave ndaj nevojave të tregut të punës dhe modernizimin e tyre, si edhe mbështetjen për trajnim dhe punësim të kategorive të veçanta, si dhe një sërë aspektesh të tjera mjaft të rëndësishme.

Për arsimin parauniversitar për periudhën 2020-2022 synohet si më poshtë :

Të sigurohet rritja e aksesit të fëmijëve në arsimin parashkollor 86%, ndjekja e arsimit bazë (nga 100% e moshës 6-16), si dhe përfshirja me përparësi e grupeve vulnerabël. Rritja e treguesit të regjistrimit me 10-15% ose 350-500 fëmijë për nxënësit romë dhe egjiptianë, 10% për nxënësit me aftësi të kufizuara. Reformimi i arsimit parashkollor dhe bazë, përmes miratimit të kornizës së re kurrikulare dhe programeve për çdo grupmoshe për arsimin parashkollor bazë. Njëkohësisht do vijojë trajnimi i përvitshëm i edukatorëve, mësuesve dhe punonjësve të shërbimit psikosocial; sigurimi i transportit të nxënësve për ndjekjen e arsimit parashkollor dhe bazë që mësojnë në një distancë prej më shumë se 2 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, si dhe mësuesve që punojnë

e banojnë më shumë se rreth 5 km nga vendbanimi. Përmirësime të ndjeshme do realizohen në arsimin e mesëm, në gjimnaze dhe arsimin e mesëm profesional në një sërë treguesish që lidhen me realizimin e programit mësimor vjetor etj.; përmirësimi i infrastrukturës shkollore, sidomos në mjediset e dëmtuara nga tërmeti i këtij viti etj..

Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor për periudhën 2020-2022 parashikohet sa më poshtë:

100% të programeve studimore të akredituara brenda vitit 2030; të sigurohet standardi një vend pune për dy studentë në laboratorë kërkimorë - shkencorë, në përputhje me parimet e barazisë gjinore; sigurimi i standardit 5-8 m² për student, sipas natyrës së programit të studimeve në vitin 2022, në përputhje me parimet e barazisë gjinore; fondet publike për IAL të arrijnë në 2% ndaj PBB në vitin 2022; 100% e të dhënave të stafit akademik, të studentëve, të karrierës akademike, diplomimit, janë në regjistrin elektronik kombëtar; 90% e stafit me kohë të plotë në departamente të jenë me grada/tituj në 2022, në përputhje me parimet e barazisë gjinore; 100% e studentëve ekselentë, studentë në nevojë të përfitojnë bursa e kredi studentore në 2022 etj.; numri i kërkuesve deri në vitin 2021 të arrijë treguesit mesatarë për kërkues në OECD; rritja me 30% e financimit të projekteve kombëtare të kërkim zhvillimit, që drejtohen nga kërkuese femra dhe doktoratave të fushave prioritare të kërkimit, me synim që pas vitit 2021, të sigurohet barazia gjinore në projektet fitues; të rritet me 10%-15% në vit numri i aplikimeve nga programet bilaterale dhe programin “Horizon 2020”, si dhe programet “ERASMUS +” etj..

Për sportin dhe rininë për periudhën 2020-2022 parashikohet: Sigurimi i mbështetjes financiare për federatat Olimpike në aktivitete europiane, botërore, ballkanike në funksion të kualifikimeve për Lojërat Olimpike Japoni 2020; mbështetja financiare me investime në sport, për ndërtimin/rindërtimin e objekteve sportive, pajisje me bazë materiale të tyre në funksion të ekipeve kombëtare; rritja e mbështetjes financiare për shpërblimin e sportistëve elitar; përmirësimi i cilësisë së jetës së të rinjve përmes rritjes së pjesëmarrjes së tyre etj..

Buxheti për Ministrinë e Kulturës

Ministria e Kulturës procesin e hartimit të PBA-së 2020-2022 e ka vlerësuar si një moment të rëndësishëm në mbështetje të objektivave të Programit të Qeverisë për zhvillimin e **Art-Kulturës, Trashëgimisë Kulturore & Muzetë**. Projektbuxheti i vitit 2020 krahasuar me projektbuxhetin e vitit 2019, ka një rritje prej 11,7 % ose 253,3 milionë lekë.

Në fushën e Trashëgimisë Kulturore rritja prej 38,6 milionë lekësh në shpenzimet korrente do të përdoret kryesisht për mbulimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e objekteve specifike, si restaurimet e afreskeve, pikturave dhe mirëmbajtje e monumenteve etj..

Në fushën e Artit dhe të Kulturës me shpenzimet korrente do të realizohen kryesisht një rrjet aktivitetsesh, që synojnë në konsolidimin e vlerave artistike, promovimin e artit shqiptar në

arenën ndërkombëtare (Bienale Venecias, Creative Europë, Traduki, Marrëveshja me Kosovën etj.).

Institucionet e vartësisë së këtij programi do të realizojnë një sërë veprimtarish artistike-kulturore, do të realizojnë premiera, si dhe rivënie. Në realizimin e veprimtarive të ndryshme artistike do të jetë prioritet integrimi, angazhimi dhe promovimi i të rinjve më të evidentuar të kësaj fushe. Por fondet që disponon MK për organizimin e këtyre aktiviteteve janë të pamjaftueshme për realizimin tyre me cilësi, *prandaj kanë kërkuar një fond prej 75 milionë lekë.*

Prioritete në vitet 2020 -2022 në fushat e kulturës dhe trashëgimisë kulturore do jenë programi kombëtar “Edukimi përmes Artit”, përmirësimi i gjendjes fizike të monumenteve të kulturës, për më tepër dhe nga dëmtimet e shkaktuara nga tërmeti i 26 nëntorit të këtij viti, përmirësimi i infrastrukturës në Muzetë Kombëtarë, Parqe Arkeologjike, edukimi përmes librit dhe veprimtarive bibliotekare, pasurimi i fondit bibliotekar në të gjithë rrjetin e bibliotekave në mbarë vendin etj..

III. KONSULTIMI PUBLIK I PROJEKTLIGJIT

Komisioni mbështetur në nenin 36, pika 1 dhe nenin 80, pika 2 të Rregullores së Kuvendit, në kuadër të gjithëpërfshirjes, transparencës dhe konsultimit publik, ka realizuar seanca dëgjimore me aktorë të interesit si: Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, RTSH-në, QKK-në, universitetet publike, si në Tiranë dhe në rrethe, ATSH-në etj..

Akademia e Shkencave ka vlerësuar mbështetjen nga qeveria për buxhetin e saj edhe për vitin 2020.

Për realizimin me efektivitet të veprimtarisë saj Akademia e Shkencave kërkon shtesë fondi prej 20 milionë lekësh. *Komisioni sugjeron të mbështetet kërkesa e Akademisë për shtesë 20 milionë lekë.*

Akademia e Studimeve Albanologjike ka vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020”, por njëkohësisht parashtroi një sërë çështjesh, që lidhen me funksionimin e saj. Duke dhënë të detajuar kërkesa për vitin 2020, investime kapitale, si rikonstruksioni i Muzeut Arkeologjik, Tiranë, rikonstruksioni i Shtëpisë së Arkeologëve Apolloni etj.. *Komisioni sugjeron të mbështetet kërkesa për një fond prej 70 milionë lekësh.*

RTSH

Drejtuesit e RTSH-së parashtroan një varg vështirësish, që lidhen me projektet teknike për futjen e teknologjikeve të reja, digjitalizimin e arkivit, funksionimin e Orkestrës Simfonike, Shërbimit për Shqiptarët Jashtë Kufirit e Shërbimi në Gjuhë të Huaj etj., ku në total janë parashikuar 634 milionë lekë. Ata kërkuan të shtohet buxheti për RTSH-në 585 milionë lekë.

Komisioni sugjeron që të mbështetet RTSH-në me 425 milionë lekë për kryerjen e veprimtarisë saj.

ATSH

Duke vlerësuar mbështetjen e të vitit kaluar nga Komisioni për kërkesat buxhetore, për vijimësinë e procesit të digjitalizimit të arkivit të fotografisë dhe buletinet e shkruara etj., kërkohet shtesë në buxhetin e vitit 2020 në vlerën 5 milion lekë.

Komisioni sugjeron që ATSH të mbështet me shtesë fondi në buxhetin e vitit 2020 në vlerën e 4 milionë lekëve.

Qendra Kombëtare e Kinematografisë(QKK)

Tavanet e Programit Buxhetor Afatmesëm 2020-2022, thekson QKK, nuk përmbushin nevojat e funksionimit saj. Kërkon shtesë fondi 40 milionë lekë për rimbursimin e pjesshëm të investimeve të produksioneve të huaja, që zhvillojnë xhirime filmi në territorin e Shqipërisë; 13 milionë shtesë fondi për projektin “Festivali i 14 Kombëtar i Filmit Shqiptar” etj..

Komisioni sugjeron që QKK-së ti shtohen 13 milionë lekë.

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave

Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave vlerësoi buxhetin e dhënë për ndërtimin e godinës për ruajtjen e fondeve arkivore, tashmë e përfunduar. Për të përmbushur misionin, për të cilin po kryhet ky investim, mbetet domosdoshmëri pajisja me raftet për vendosjen e fondeve arkivore, që sipas preventivit paraprak shkon afërsisht në shumën prej 80 milionë lekë të kërkuara nga DPA-ja.

Miratimi i pjesës tjetër të investimit prej 80 milionë lekësh për raftet, është mjaft i rëndësishëm, për të përfunduar me sukses ndërtimin e vendruajtjes së dokumenteve në Shkozë. Ky është investimi më i madh për arkivat në 30 vjet dhe krijon mundësi për ruajtjen e dokumenteve me rëndësi historike kombëtare dhe për 7 dekada të tjera.

Komisioni sugjeron që të mbështetet kërkesa e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave për të realizuar veprimtarinë e saj.

Universitetet Publike

Në seancat dëgjimore të organizuara me rektorë dhe administratorë të universiteteve publike të Universitetit të Tiranës, Universitetit të Sporteve të Tiranës, Universitetit të Mjekësisë të Tiranës, Universitetit “Aleksandër Xhuvani” të Elbasanit, Universitetit “Ismail Qemali” të Vlorës, Universiteti “Fan St Noli” të Korçës, si dhe në materialet e dërguara me shkrim nga Universiteti Politeknik i Tiranës dhe Universiteti “Aleksandër Moisiu” të Durrës, vlerësohet buxheti i këtij viti, i cili krahasimisht me vitin e kaluar parashikon rritje të fondeve të buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë. Grantin e politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë (rritja 14 %); grantin i mësimdhënies (rritja 32%); grantin e punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese (rritja 5%).

Universiteti i Tiranës vlerëson projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020”, kërkon rritjen e tij për përmirësimin e kushteve të studentëve, veçanërisht u përqëndrua në çështjen e doktoraturave, për të cilat kërkohen fonde etj..

Universiteti Mjekësor i Tiranës

UMT kërkon të mbështetet nga pikëpamja financiare përmes: mbulimit për 12 muaj të pagave dhe sigurimeve shoqërore; mbështetje financiare për të realizuar një shtesë të ambienteve të mësimdhënies për Fakultetin e Mjekësisë Dentare (FMD); mbështetje financiare për të realizuar një shtesë të ambienteve të mësimdhënies për Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike (FSHMT).

Universiteti i Sporteve i Tiranës, duke vlerësuar buxhetin e këtij viti, u ndal në specifikat që ka ky universitet dhe në lidhje me buxhetin kërkoi investime kryesisht në ambiente, në të cilat janë gati projektet dhe pajisje për laboratorët. Për rikonstruksionin e fushës së futbollit dhe pistës së atletikës nga buxheti kërkohen 45.000.000 lekë. Për ndërtimin e shtesës së palestrës së gjimnastikës, kërkesë edhe e studentëve, kërkohen fonde 31 912 000 lekë. Ndërtimi i pishinës, ndërtimi i një ndërtese katërkatëshe etj., kërkon fonde të shumta, që mundësojnë zhvillimin normal të procesit mësimor në Universitetin e Sporteve.

Universiteti Politeknik i Tiranës vlerëson rritjen e fondeve të buxhetit të shtetit për institucionet e arsimit të lartë në Grantin e politikave të zhvillimit për institucionet publike të arsimit të lartë (rritja 14 %); grantin e mësimdhënies (rritja 32%); grantin e punës kërkimore-shkencore dhe veprimtarive krijuese (rritja 5%). Kërkon që procesi i shpalljes së thirrjeve, vlerësimit të projekteve dhe alokimit të fondeve nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, të nisë që në fillim të vitit financiar, pasi në të kundërt rrezikohet që këto fonde për shkak të kohës së shkurtër në dispozicion që mbetet për IAI-të, të mos shpenzohen. Duke u ndaluar në lëkundjet sizmike që ndodhën së fundi, thekson se është emergjente nevoja për ndërhyrje dhe rehabilitimin strukturor të godinave, ku ndër prioritet kryesore për të cilin kërkohet financim në vitin 2020, renditet projekti për rehabilitimin infrastrukturor të godinës së Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit dhe Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, pa përmendur godinën historike të Fakultetit të Gjeologjisë dhe Minierave, për të cilën fondet janë siguruar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, nëpërmjet donacioneve të subjekteve që ushtrojnë veprimtarinë në industrinë e gazit, naftës dhe atë minerare etj..

Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan, parashtroi kërkesat për mbarvajtjen e procesit akademik e kërkimor dhe realizimin e planit kombëtar për integrimin europian 2016–2020, duke theksuar se është e nevojshme: rimbursim nga Buxheti i Shtetit 100% të të ardhurave që nuk arkëtohen, si pasojë e zbatimit të akteve nënligjore për uljen apo reduktimin e pagesës së tarifave të shkollimit; financimi nga Buxheti i Shtetit i fondeve të kërkimit shkencor; financimi nga Buxheti i Shtetit i objektit “Ndërtim i godinës Fakultetit të Shkencave Humane” për vlerën 489,455 mijë lekë, ndërkohë që nga të ardhurat Universiteti ka dy vite që janë ngurtësuar në Degën e Thesarit fondi nga të ardhurat, prej 140,000 mijë lekë; financimin nga Buxheti i Shtetit të projekteve për pajisjet laboratorike.

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, kërkoj shtesë në buxhet për ngritjen e godinës së re për Fakultetin e Shendetit Publik; përmirësimin e sistemit të ngrohjes së godinave; shtimin e laboratorëve (Inxhinieria elektrike, mekanike, navigacioni, pedagogji e specializuar, infermieri); rritje të fondit për kërkimin shkencor dhe përfshirjen e studentëve në kërkimin shkencor.

Universiteti “Fan St Noli” Korçë, në kuadër të hartimit të Projektit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2020-2022, referuar Paktit për Universitetin, shprehu nevojat për mbështetje financiare referuar VKM, nr.39, datë 23.01.2019 dhe VKM nr.40, datë 23.01.2019; kërkojnë me domosdoshmëri financimin e projektit të rikonstruksionit të godinës së Fakultetit Ekonomik, vlera e paraprake e projektit në fjalë është 62,500,000 lekë; kërkohet rritje e financimit buxhetor për përmirësimin e kushteve dhe infrastrukturës së laboratorëve e pajisjeve profesionale në shumën 30,420,000 lekë, për plotësimin e kërkesave për krijimin e laboratorëve të rinj në fusha të ndryshme studimi; rritje prej 4,000,000 lekësh për kërkimin shkencor të universitetit.

Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës, kërkon që qeverija të vazhdojë të mbështesë Universitetin “Aleksandër Moisiu” Durrës, duke garantuar fonde për mbështetjen studentore për të përballuar të gjithë efektin financiar që sjell zbatimi i VKM-së nr. 39, datë 23.01.2019; VKM-së nr. 40, datë 23.01.2019 etj.. Ky universitet në vitin 2018 ka përfunduar ndërtimin e godinës së dytë të Kampusit Universitar. Aktualisht institucioni ka ende të pashlyer një vlerë të konsiderueshme detyrimi të kontratave që lidhen me ndërtimin e kësaj godine, konkretisht kontrata e ndërtimit, kontrata e arredimit të brendshëm etj.. Në vitin 2020 të ardhurat e institucionit pritet të shkojnë për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura. Nisur nga ky fakt kërkojnë rritjen e buxhetit për vitin 2020, për të përballuar të gjitha shpenzimet për funksionimin e institucionit (shpenzime për personelin dhe shpenzime operative të domosdoshme). Po kështu kërkohet shtesë buxheti për financimin e projekteve kërkimore - shkencore.

Komisioni është njohur dhe me materialet e dërguara me shkrim nga aktorë të interesit dhe të shoqërisë civile, si Zyra e UNICEF-it në Shqipëri, Kualicionin për Arsimin në Shqipëri, Shoqata e Fëmijëve me Aftësi Ndryshe etj., thelbin e të cilave e përbëjnë të drejtat e fëmijëve në politikat publike dhe buxhet duhet të jenë prioritet, të rritet buxheti i arsimit në arsimin parashkollor, arsimin e mesëm dhe të lartë, duke synuar që investimet në arsim të arrijnë 5% të PBB-së; alokim të burimeve efikase dhe të mjaftueshme, qoftë financiare dhe materiale, si dhe buxhet i duhur për staf të trajnuar rregullisht dhe në mënyrë të përshtatshme, që fëmijë me aftësi të kufizuara, por edhe fëmijë nga grupe të tjera vunerabël të përfshihen në shkollë, financimin e shkollave qendër komunitare, fonde për të mbuluar shpenzime për bursa, çështje që lidhen me mësuesit ndimës etj.

IV. PËRFUNDIM

Në përfundim, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik, duke vlerësuar projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2019” në tërë komponentët e tij, me votat e të gjithë deputetëve të pranishëm miratoi nen për nen dhe në tërësi projektligjin “Për Buxhetin e Vitit 2020” dhe i paraqet Raportin e tij Komisionit për Ekonominë dhe Financat.

RELATORE

Lindita NIKOLLA

ZV/ KRYETARE

Milva EKONOMI

